



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave  
Ministry of Local Government Administration*

Prishtinë, 30 qershor 2014

# Raport gjashtëmujor i punës së MAPL-së



Ky raport paraqet punën e MAPL-së për periudhën janar – qershor, 2014. Këtu janë përfshirë në mënyrë të përmbledhur aktivitetet e të gjitha njësive organizative të MAPL-së duke u koncentruar në pesë fusha kryesore, të cilat përbëjnë objektivat e punës së ministrisë.

## Përmbajtja

|  |    |
|--|----|
| Shkurtesat .....   | 3  |
| Përmbledhje ekzekutive .....   | 4  |
| 1. Zhvillimi dhe Zbatimi i Legjislacionit .....                        | 5  |
| 2. Avancimi i reformës së Pushtetit Lokal .....                        | 7  |
| 3. Koordinimi i politikave dhe koordinimi ndër-institucional .....     | 9  |
| 4. Zhvillimi regjional dhe promovimi i zhvillimit Ekonomik Lokal.....  | 10 |
| 5. integrimet Evropiane dhe Promovimi i Bashkëpunimit Ndërkufitar..... | 13 |
| 6. Transparenca e punës së komunave .....                              | 15 |
| 7. Zhvillimi i Kapaciteteve dhe Performanca Komunale.....              | 16 |
| 8. Promovimi i të drejtave të njeriut në Komuna .....                  | 19 |
| 9. Administrata dhe Financat.....                                      | 21 |

## Shkurtesat

|               |  |
|---------------|--|
| <b>BNK</b>    | Bashkëpunimi Ndërkufitar   |
| <b>DIEKP</b>  | Departamenti për integritime Evropiane dhe Koordinim të Politikave   |
| <b>DIE</b>    | Divizioni për integritime Evropiane                                  |
| <b>DKP</b>    | Divizioni për Koordinim të Politikave                                |
| <b>GIZ</b>    | Bashkëpunimi Gjerman për Zhvillim                                    |
| <b>IE</b>     | Integritimet Evropiane   |
| <b>KEVL</b>   | Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale                             |
| <b>LVL</b>    | Ligji për Vetëqeverisje Lokale                                       |
| <b>MAPL</b>   | Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal                         |
| <b>MASHT</b>  | Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë                       |
| <b>MF</b>     | Ministria e Financave  |
| <b>MIE</b>    | Ministria e integritimeve Evropiane                                  |
| <b>MPB</b>    | Ministria e Punëve të Brendshme                                      |
| <b>MMPH</b>   | Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor                      |
| <b>MBPZH</b>  | Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural               |
| <b>MRKS</b>   | Ministria për Rinia, Kulturë dhe Sport                               |
| <b>MZHE</b>   | Ministria e Zhvillimit Ekonomik                                      |
| <b>PVNMSA</b> | Plani i Veprimit për Negocimin e Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit |
| <b>SVL</b>    | Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2015 - 2025                      |
| <b>UNDP</b>   | Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim                         |
| <b>USAID</b>  | Agjensioni për Zhvillim Ndërkombëtar                                 |
| <b>ZKM</b>    | Zyra e Kryeministrit   |

## Përmbledhje ekzekutive

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) në përputhje me mandatin e saj dhe me objektivat e Deklaratës Prioritare të Politikave Afatmesme 2014 - 2016, është përqendruar në përmbushjen e planit të punës të gjashtëmujorit të parë, të vitit 2014. Raporti pasqyron veprimet dhe rezultatet e arritura të MAPL-së sipas fushave përkatëse të planifikuara.

Gjatë kësaj periudhe MAPL është përqendruar në realizimin e detyrave në fushat, si vijon: 1. Zhvillimin dhe zbatimin e legjislacionit të qeverisjes lokale; 2. Avancimi i reformës së Pushtetit Lokal; 3. Koordinimi i politikave dhe koordinimi ndër-institucional; 4. Zhvillimi regjional dhe promovimi i zhvillimit Ekonomik Lokal; 5. integrimet Evropiane dhe Promovimi i Bashkëpunimit Ndërkufitar; 6. Transparenca e punës së komunave; 6. Zhvillimi i Kapaciteteve dhe Performanca Komunale; 7. Promovimi i të drejtave të njeriut në Komuna; dhe ystjet tjera që ndërlidhen me administrimin e brendshëm dhe financat e MAPL-së.

Në bazë të informatave nga departamentet përkatëse dhe njësitë tjera organizative të MAPL, vërehet një zhvillim i punëve në shumë dimensione, me shumë veprime dhe me rezultate të rëndësishme të arritura gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2014. Nga fusha e zhvillimit dhe e zbatimit të legjislacionit është hartuar Projektligji për Emrat, Numrat dhe Kufijtë Administrativ të Komunave, hartimi i raportit gjithëpërfshirës për monitorimin e funksionimit të komunave, Projekt-Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 04/2014 për Thirrjen e Mbledhjeve të Kuvendeve të Komunës, etj. Në avancimin e reformës së pushtetit lokal dhe koordinim të politikave është hartuar Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2015 - 2025, është hartuar plani i punës së MAPL/2014, janë hartuar politikat prioritare të MAPL për periudhën 2015 - 2017, historiku i organizimit administrativ dhe territorial të VQL në Kosovë etj. Gjatë kësaj periudhe MAPL ka përkrahur komunat lidhur me zhvillimin ekonomik lokal, sidomos nga fondi për zhvillim rajonal, është shënuar progres në bashkëpunimin ndërkufitar në tri programet: Kosovë - Shqipëri, Kosovë - Maqedoni dhe Kosovë - Mal i Zi, si dhe në bashkëpunimin ndërkomunal.

MAPL duke u bazuar në mandatin e saj, u ka ofruar përkrahje të rëndësishme komunave në përmbushjen e detyrimeve që dalin nga procesi i integritimeve evropiane, në veçanti në ndërtimin e kapaciteteve profesionale. Transparenca e punës së komunave për MAPL është bërë prioritet kryesor gjatë këtij gjashtëmujori të parë. Gjithashtu, sa i përket fushave si: ngritja e kapaciteteve, vlerësimi i performancës dhe respektimi i të drejtave të njeriut në komuna, janë realizuar shumë aktivitete . Ndërsa, është bërë bashkërendim i veprimeve edhe me partnerët e ndryshëm vendorë dhe ndërkombëtarë me qëllim të avancimit dhe zhvillimit të vetëqeverisjes lokale në Kosovë.

## 1. Zhvillimi dhe Zbatimi i Legjislacionit

MAPL në gjashtëmujorin e parë të vitit 2014 ka zhvilluar aktivitete sa i përket zhvillimit të legjislacionit primar dhe sekondar. Lidhur me këtë është hartuar Projektligji për Emrat, Numrat dhe Kufijtë Administrativ të Komunave dhe sipas afateve të përcaktuara nga agjenda legislative, ky projektligj do të procedohet për një fazë të mëtutjeshme. Po ashtu është hartuar drafti i parë i Koncept-dokumentit për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën dhe është mbajtur takimi i Grupit punues. Ndërsa, me qëllim të kompletimit dhe konkretizimit të procedurave nga legjislacioni primar, gjatë periudhës së raportimit janë hartuar dhe miratuar aktet nënligjore, si vijon:

- Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 2014/01 për Procedurën e Emërimit të Nënkryetarëve në Komuna;
- Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 02/2014 MAP Nr. 01 për Caktimin e Stafit Mbështetës në Komuna;
- Projekt-Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 03/2014 për Organizimin dhe Funksionimin e Komiteteve të Obliguar në Komunë;
- Projekt-Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 04/2014 për Thirrjen e Mbledhjeve të Kuvendeve të Komunës;
- Projekt-Rregullorja për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Akteve të Komunave;
- Projekt - Udhëzimi Administrativ për simbolet në komuna i cili është në fazën e draftimit i iniciuar në bashkëpunim me MAP, Zyrën e Kryeministrit dhe MAPL-në.

Duke u bazuar në Rregulloren Nr. 09/2011 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, MAPL është konsultuar paraprakisht nga Ministritë e linjës lidhur me legjislacionin sektorial që ndikon në vetëqeverisjen lokale. Gjatë kësaj periudhe janë pranuar për konsultim 60 akte nënligjore, 9 Projekt-ligje, 32 Projekt-Udhëzime Administrative, 8 Koncept-Dokumente, si dhe 11 Projekt-Rregullore. MAPL ka dërguar shkresa konfirmuese ministrive të linjës lidhur me harmonizimin e këtyre projekt-akteve me legjislacionin e zbatueshëm për vetëqeverisje lokale. Gjithashtu është finalizuar "Mekanizmi për zbatimin e obligimeve ligjore për komunat që dalin nga ligjet" 2008 - 2013 dhe "Doracakun për obligimet ligjore të komunave" 2010/2013. Është adresuar shkresa tek ZKM lidhur me konsultimin paraprak të 35 projektligjeve që ndikojnë në vetëqeverisjen lokale dhe që janë pjesë e Programit Legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2014.

Në fillim të vitit 2014, gjithsejtë gjashtë (6) komuna: Leposaviqi, Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Zveçan, Partesh dhe Skenderaj kanë mbajtur mbledhjet inauguruese me ç'rast janë konstituuar edhe këto organe komunale për të implementuar rezultatet e zgjedhjeve lokale të mbajtura në nëntor të vitit 2013. Në këtë periudhë të raportimit është bërë edhe ri-vlerësimi i Statuteve të komunave Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe Mitrovicë Veriore nga kuvendet e këtyre komunave dhe të njëjtat janë harmonizuar me legjislacionin për vetëqeverisje lokale. gjatë kësaj periudhe janë pranuar dhe shqyrtuar 24 ankesa lidhur me shkeljen e dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin Nr. 04/L-144, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Ligjit për Shërbim Civil në Republikën e Kosovë Nr. 03/L-149 dhe shkelje të tjera procedurale.

Gjithashtu, janë pranuar dhe vlerësuar 32 kërkesa për rishqyrtim të cilat ndërlidhen me organizimin dhe funksionimin e vetëqeverisjes lokale, 3 konsultime paraprake lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale si dhe për konfliktin e interesit të anëtarëve të kuvendit. Gjatë kësaj periudhe të raportimit janë hartuar 5 këshilla ligjore lidhur me; pozitat e dyfishta në komuna, zgjedhje të kryesuesve të kuvendeve të komunave, shkresa për formimin e Këshillave Lokale për Siguri në Bashkësi, shkresa për inaugurimin e organeve të komunës, shkresa për kthimin e pronoës së paluajtshme - tokës në menaxhim dhe administrim të komunave nga Agjensioni Kosovar i Privatizimit. Janë hartuar shkresa përcjellëse për obligimet konkrete që kanë komunat pas publikimit të ligjeve në gazetën zyrtare të Republikë së Kosovës, duke përfshirë këto ligje: Ligjin Nr. 04/L-247, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për Shitjen e Banesave për të cilën ekziston e Drejta Banesore, Ligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-050 për Deklarimin Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtar; Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-127, për Regjistrimin e Bujqësisë, dhe Ligjin Nr. 04/L-188 Për Trajtimin e Ndërtimeve Pa Leje.

Po ashtu, është hartuar raporti i monitorimi dhe funksionimit të komunave të Republikës së Kosovës për gjashtë mujorin e parë të vitit 2014. Kuvendet e Komunave gjatë kësaj periudhe kanë mbajtur gjithsej, 225 mbledhje. Prej tyre, janë monitoruar 216 mbledhje, apo shprehur në përqindje 96% të mbledhjeve të mbajtura. Sa u përket akteve, janë miratuar gjithsej, 1081 akte, prej të cilat janë dhënë 664 konfirmime të ligjshmërisë nga MAPL, ndërsa janë evidentuar 29 shkelje të akteve nënligjore të komunave, prej të cilave 18 janë rishqyrtuar ndërsa 11 janë ende të pa-harmonizuara me legjislacionin e zbatueshëm. Janë adresuar gjithsej 253 akte të komunave për shqyrtim dhe vlerësim të ligjshmërisë tek Ministrinë e linjës dhe Komisionet Sektoriale për vlerësim të ligjshmërisë së akteve të komunave (MMPS, MBPZHR, MF, MRKS, MMPH) ashtu siç parashihet me

vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Aktet e miratuara nga kuvendet e komunave në mbledhjet e muajit qershor janë në proces të shqyrtimit të ligjshmërisë, disa prej tyre ende nuk janë pranuar nga komunat marr parasysh që mbledhjet janë mbajtur në fund të këtij muaji.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka hartuar Planin për Monitorimin e komunave lidhur me këto objektiva: zhvillim dhe zbatimin e legjislacionit nga organet e komunës, monitorimi i punës së organeve të komunave në funksionalizmin e trupave ndihmës në komuna dhe transparencë komunale; monitorimi i nxjerrjes së legjislacionit sekondar bazuar në afatet ligjore të përcaktuara me legjislacionin primar për vetëqeverisje lokale dhe legjislacionit sektorial; si dhe verifikimi i emërtimeve të vendbanimeve (fshatrave) që janë dërguar në MAPL e cila do të jetë shtojcë e ndryshim plotësimit të Ligjit për emrat dhe kufijtë administrativë të Komunave. Bazuar në këtë plan janë monitoruar gjithsejtë 34 komuna dhe janë në fazën finale raportet e monitorimit për secilën komunë veç e veç. Është hartuar dokumenti për mekanizmat që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen e komuniteteve në punën e organeve të komunave në zhvillimin dhe zbatimin e politikave lokale. Po ashtu, janë hartuar disa dokumente të cilat ndërlidhen me zbatimin e legjislacionit për simbolet shtetërore dhe simboleve e komunave, vulat, emblemat, përdorimin e monumenteve në komuna si dhe dokumente ligjore për rolin e Asociacionit të Komunave. Ndërsa, plani për implementimin e rezultateve zgjedhore ka vazhduar edhe në fillim të vitit 2014. Për këtë qëllim është hartuar Udhëzuesi për inaugurimin dhe funksionalizimin e organeve të komunave dhe është dërguar në komuna pas certifikimit të rezultateve.

## **2. Avancimi i reformës së Pushtetit Lokal**

MAPL është angazhuar dhe ka adresuar kërkesat e Komunave për themelimin e Komunave të reja në Qeveri. Pas miratimit të këtyre kërkesave, MAPL ka filluar procedurat për themelimin e tri (3) komunave të reja. Me këtë rast janë bërë ndryshimet e nevojshme në draft-ligjin për për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Kufijtë Administrativ Komunal, i cili parasheh themelimin e tri (3) komunave të reja: Komuna e Rogovës, Komuna e Gjonajt dhe Komuna e Zhegrës. Në gjithë procesin konsultativ MAPL është angazhuar të realizojë takime dhe konsultime me qytetarët dhe përfaqësuesit e këtyre lokaliteteve dhe fshatrave përreth si dhe me kryetarët e komunave amë, të cilave u përkasin këto lokalitete, respektivisht komunës së Gjakovës, Prizrenit dhe Gjilanit.

Po ashtu bazuar në Vendimi Nr. 12/189 i datës, 23.05.2014 për inicimin dhe Zhvillimin e procedurave ligjore për themelimin e Komunës së re të Kijevës, Komoranit, Rugovë të Pejës, si dhe Hogosht të Kamenicës, MAPL ka filluar procedurat për themelimin e ktyre

komunave të reja. Në kuadër të përgatitjeve për themelimin e komunave, është përgatitur pyetësoi për marrjen e të dhënave për lokalitetet që do të jenë pjesë e komunave të reja ku në bazë të këtyre të dhënave janë hartuar profilet e tyre, ndërsa, në bashkëpunim me Agjencinë Kadastrale të Kosovës janë caktuar kufijtë preliminar të këtyre lokaliteteve që do të jenë komuna në të ardhmen (hartat) si dhe janë përgatitur procedurat paraprake për ngritjen dhe funksionimin e ekipeve përgatitore komunale. Është përgatitur buxheti për tri komunat e reja për vitin 2014, për funksionimin e administratës komunale, bazuar në kriteret për madhësinë e administratës komunale.

Me qëllim të avancimit të vetëqeverisjes lokale, sipas dokumentit për politikat strategjike të Qeverisë, MAPL fillimisht ka zhvilluar analizën e të dhënave nga strategjitë ndërsektoriale dhe ka finalizuar punën për draftimin e Strategjisë për vetëqeverisjen Lokale 2015-2025. Në këtë dokument janë përcaktuar orientimet strategjike, veprimet dhe qasjet për zhvillimin e vetëqeverisjes lokale për 10 vitet e ardhshme. Ndërsa, me qëllim të konsolidimit të draftit të strategjisë, dokumenti është diskutuar në grupin punues ndërsektorial si dhe në serinë e konsultimeve regjionale me kryetarët e komunave të Republikës së Kosovës, kryesuesit e kuvendeve të komunës anëtarët e kuvendeve të komunës, shoqërinë civile dhe përfaqësues të bizneseve nga rajonet: Pejë, Gjiilan dhe Prizren. Gjithashtu, Draft Strategjia është publikuar në faqen zyrtare të internetit të MAPL-së, me ç'rast i është vënë në dispozicion publikut të gjerë që të japin komentet dhe sugjerimet në mënyrë që drafti i strategjisë të jetë sa më gjithëpërfshirës. Pas kësaj faze, të gjitha komentet dhe sugjerimet, janë inkorporuar në draft dhe pritet që gjatë muajve në vijim, drafti të procedohet për miratim në Qeveri.

Ndërkaq, për nevojat e përcaktimit të objektivave strategjike, përveç dokumenteve tjera, MAPL paralelisht me Strategjinë për vetëqeverisjen lokale ka hartuar dokumentin konceptual për hartimin e politikave në vetëqeverisjen lokale, pastaj dokumentin analitik për Historikun dhe Organizmin Administrativ dhe Territorial të Vetëqeverisjes Lokale në Kosovë, duke përfshirë këtu organizimin administrativ dhe territorial të VQL në Kosovë, ligjet, rregulloret, si dhe shumë aspekte tjera të rëndësishme të cilat e kanë përcjellë Kosovën, nga etapa në etapë deri në ditët e sotme. Më tej, është hartuar analiza lidhur me pasqyrimin e përvojave evropiane dhe rajonale në avancimin e vetëqeverisjes lokale, si dhe analiza rreth kompetencave të komunave në Republikën e Kosovës dhe krahasimet fillimisht në mes të rregulloreve të UNMIK-ut me LVL, pastaj edhe krahasimet e kompetencave të komunave të Republikës së Kosovës me kompetencat e vendeve të rajonit dhe vendet e BE-së, analiza e pasqyrimin të përvojave rajonale dhe evropiane në avancimin e qeverisjes lokal dhe analiza e dhe zbatimit të frymës së Kartës Evropiane në organizimin dhe funksionimin e vetëqeverisjes lokale në Kosovë. Në këtë periudhë rëndësi të veçantë ka pasur pasurimi i vazhdueshëm dhe funksionalizimi i



bibliotekës së MAPL-së me ç'rast është bërë kategorizimi dhe vendosja fizike e librave, pastaj është bërë funksionalizimi i bazës së të dhënave me dokumentet e qeverisjes lokale, si dhe hartimi i udhëzimit për shfrytëzimin e bibliotekës.

### **3. Koordinimi i politikave dhe koordinimi ndër-institucional**

Gjatë kësaj periudhe janë koordinuar të gjitha veprimet me departamentet dhe njësitë tjera organizative të MAPL-së për hartimin e raporteve vjetore të punës së MAPL-së që përdoren për nevojat e MAPL-së dhe për raportim në qeveri: si raporti i rregullt i punës së MAPL-së për Qeverinë dhe raporti për zbatimin e vendimeve të Qeverisë. Krahas këtyre, është raportuar edhe për punën e MAPL-së për K4 - 2013 dhe raporti i zbatimit të vendimeve të Qeverisë për K4 - 2013. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe është hartuar raporti tremujor për MAPL-në, raporti për Qeverinë dhe raporti për zbatimin e vendimeve të Qeverisë për periudhën janar - mars, 2014. Gjithashtu MAPL ka koordinuar gjithë aktivitetin sa i përket përmbushjes së detyrimeve nga agjenda evropiane (takimet dhe raportimet për nën-sektorë: infrastruktura, ambienti, dtejtësia si dhe procesin e liberalizimit të vizave) në raport me komunat.

MAPL gjatë kësaj periudhe ka bërë koordinimin e politikave brenda ministrisë dhe koordinimin e politikave ndër-institucionale, me institucionet tjera qendrore dhe lokale. Në këtë drejtim, është bërë hartimi i planit të punës së MAPL për vitin 2014. Për këtë qëllim, në bashkëpunim me Projektin GIZ, është organizuar punëtorja në Shqipëri me temë: *"Avancimi i Shërbimeve Publike dhe Planifikimi për vitin 2014"*, ku janë diskutuar modelet e planifikimit dhe është përfunduar plani i punës së MAPL-së për vitin 2014. Aktivitetet janë koordinuar edhe me rastin e analizës rreth implementimit të planit të punës së MAPL-së si dhe në vazhdimësi janë koordinuar politikat ndër-sektoriale. Në vazhden e koordinimit të politikave ndërmjet nivelit qendror dhe lokal, MAPL ka hartuar tri politika të reja prioritare për periudhën 2015 - 2017, në përputhje me kërkesat për zhvillimin e KASH të së njëjtës periudhë.

Koordinimi i aktiviteteve gjatë kësaj periudhe është fokusuar sidomos në punën për funksionalizimin e organeve komunale me qëllim të implementimit të rezultateve zgjedhore e sidomos funksionalizimin e organeve lokale të katër komunave: Zubin Potok, Zveçan, Leposaviq dhe Mitrovicë e veriut. Gjatë këtij procesi janë mbajtur takime të rregullta konsultative, janë hartuar udhëzues dhe janë dhënë këshilla ligjore për implementimin e kornizës ligjore për vetëqeverisjen Lokale. Në këtë drejtim, MAPL rregullisht ka marrë pjesë në bisedimet në Bruksel, me qëllim të koordinimit ndër-institucional sa i përket obligimeve për implementimin e marrëveshjes së Brukselit. Në vazhden e aktiviteteve të saj, MAPL ka vazhduar me koordinimin e aktiviteteve me organizatat ndërkombëtare. Ka siguruar që puna e kryetarëve të rinj në katër komunat

(Mitrovicë e veriut, Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq) të mbështetet nga asistenca teknike e donatorëve: UNDP dhe USAID si dhe në bashkëpunim me UN-HABITAT është mbajtur takimi me kryetarët e Komunave, me qëllim të diskutimit të planeve zhvillimore lokale. Gjithashtu janë bashkërenduar të gjitha aktivitetet sa i përket përmbushjes së obligimeve të MAPL-së dhe Komunave nga raporti i progresit dhe Plani i Veprimit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit.

#### **4. Zhvillimi regional dhe promovimi i zhvillimit Ekonomik Lokal**

Zhvillimi regional dhe promovimi i zhvillimit ekonomik lokal janë prioritet i MAPL-së, madje edhe ndër objektivat kryesore të deklaratës prioritare të politikave të MAPL-së. Andaj, në tremujorin e parë të vitit 2014 MAPL kanë filluar vlerësimet e Programit Komunal për Zhvillim Rajonal dhe Socio Ekonomik në Komunitet e Republikës së Kosovës nga fondi i MAPL-së për zhvillim regional me ç'rast MAPL ka pranuar 21 projekte nga 21 komuna (ku një komunë mund të jetë lidere në udhëheqjen e projektit me disa partnere). Kërkesat e projekteve kanë qenë nga: Rajoni Qendër ka aplikuar me 6 projekte, Rajoni Veri ka aplikuar me 3 projekte, Rajoni Jug ka aplikuar me 1 projekte, Rajoni Lindje ka aplikuar me 6 projekte dhe Rajoni Perëndim ka aplikuar me 5 projekte. Gjatë kësaj faze duhet cekur se 13 komuna janë vlerësuar pozitivisht sa i përket kriterëve për fondin e zhvillimit regional, kurse 3 komuna tjera nuk i kanë plotësuar kushtet administrative dhe 5 komuna tjera janë që nuk i kanë plotësuar kriteret e përgjithshme sipas aplikacionit në fjalë.


Ndërsa, lidhur me promovimin dhe zhvillimin ekonomik, MAPL gjatë kësaj periudhe është koncentruar në funksionalizimin e plotë të strukturave lokale në Komunën e Zubin Potokut, Zveçanit, Leposaviqit dhe Mitrovicës Veriore. Me këtë rast nga perspektiva buxhetore komunale janë përgatitur raporte lidhur me investimet kapitale në këto komuna duke përfshirë periudhën nga viti 2003 deri në vitin 2013. Në këtë drejtim, është bërë edhe identifikimi i nevojave për investime për komunat: Mitrovicë Veriore, Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq, si dhe është përgatitur një dokument përmbledhës për investime lidhur me këto projekte. Në vazhdim është përgatitur programi i investimeve kapitale për komunat e përfshira në procesin e decentralizimit. Me qëllim të pasqyrit të performancës financiare të Komunave, MAPL ka përmbledhur dhe publikuar nga një këndvështrim analitik, raportet e auditorit të përgjithshëm për periudhën 2011, 2012, të cilat raporte do të përdoren si një ndër kriteret kryesore për t'i mundësuar qasjen komunave në hua. Sa i përket financimit të komunave, MAPL ka përgatitur shkresa për sekretarinë e komisionit të grandëve lidhur me dërgimin e dokumenteve për diskutim si dhe rekomandimet për komisionin e grandëve për financim komunal 2015-2017.

Gjithashtu, është përgatitur thirrja për propozime për OJQ-të, të cilat do të kontribuojnë në promovimin e të hyrave vetanake të komunave, si dhe janë hartuar raportet vjetore për të hyrat vetanake, për shpenzimet komunale, dhe raportet vjetore për investime kapitale bazuar në burimet e financimeve dhe raporti lidhur me obligime financiare të pakryera të komunave deri në vitin 2013. Me qëllim të pasqyrimin të trendëve të planifikimit dhe realizimit të të hyrave për periudhën trevjeçare është përgatitur analiza për të hyrat vetanake. Në vazhdim të bashkëpunimit dhe bashkërendimit me institucionet e tjera lidhur me buxhetet e katër komunave në veri janë mbajtur takimi me përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Administratës Publike, Ministria e Financave dhe projekti USAID-DEMI. Meqenëse komunat kanë të drejtë të marrin hua, është përgatitur dokumenti për identifikimin e obligimeve ligjore lidhur me huat komunale. Janë mbajtur dhjetë takime me komisionin e përbashkët MF-MAPL për vlerësim të ligjshmërisë së rregulloreve për tarifa ngarkesa dhe gjoba. Në vazhdim përfaqësues nga MAPL kanë marrë pjesë në dy takime të komitetit drejtues të projektit", *Mbështetje për MF*". Gjithashtu në muajin mars është mbajtur një takim me institutin - GAP lidhur me buxhetin e komunës së Prishtinës.

Aktivitetet tjera MAPL ka pasur edhe në kuadër të menaxhimit dhe zbatimit të projekteve që kanë karakter të zhvillimit ekonomik- lokal në pushtetin lokal. Në këtë drejtim, gjatë kësaj periudhe janë pranuar 17 kërkesa individuale nga komunat si dhe 71 aplikacione tjera nga komunat bazuar në udhëzuesin për aplikim. Po ashtu, ka vazhduar freskimi i vazhdueshëm i bazës së të dhënave të investimeve për 4 vitet e fundit nga të gjitha fondet e MAPL-së dhe BE-së, ku është finalizuar raporti për këto investime. Vlen të theksohet se është bërë hartimi i kritereve për platformën CMS/CSC dhe pritet të lansohet thirrja për propozime nga SDC (Swiss development Cooperation) që do të mbulojë periudhën 3 vjeçare për avancim dhe mirëmbajtje të kësaj platforme, është formuar komisioni për menaxhimin e projekteve të MAPL-së. Janë në proces të hartimit të termave të referencës së bashku ekspertit të platformës si dhe IT-së MAPL -se për të cilën deri tani janë aranzhuar 10 takime në komuna. Po ashtu janë lansuar fondet bazuar në kritere për fondet e MAPL-se 2.5 milion për infrastrukture, me ç'rast janë organizuar edhe sesione informuese për mënyrën e aplikimit të komunave me projekte konkrete. Deri më tani janë pranuar kërkesat nga 37 komuna me 82 projekte në vlerë mbi 12 milion € për projekte që do të financohen, nga fushave të ndryshme: rrugë, kanalizim, ujësjellës, rehabilitim të objekteve shkollore dhe shëndetësore, ndriçim publik solar, rregullim i parqeve dhe shtratit të lumenjve, etj.

Sa i përket numrit të projekteve që do të financohen në këtë vit 2014, aktualisht janë 37 projekte në vlerë prej 3,139,525.50€. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe është nënshkruar kontrata për projektin "*Ndërtimi i stacionit policor faza e dytë - komuna e Kllokotit*". MAPL

ka vazhduar përkrahjen e komunave vazhdimisht, sidomos në fushën e investimeve kapitale duke përfshirë këtu edhe financimin nga Programi infrastrukturës, bashkëfinancimin me IPA, Programi për Zhvillim ekonomik Rajonal (EURED) dhe nga fondi i MAPL-së për zhvillim rajonal, IPA-s me zyrën e BE-së në Kosovë ku përfshihet Programi i infrastrukturës Ekonomike dhe Sociale të komunave MUNIINFRA faza VII dhe projekti masat e efencës së energjisë në objektet publike shkollore dhe shëndetësore. Nga programi i infrastrukturës MAPL në vitin 2013 ka financuar 34 projekte, ku përfituese janë 21 komuna. investime janë bërë në fusha të ndryshme si në vijim:




Rrugë, 21 projekte në vlerë prej 1,597,501.50€, Ndrizim publik, 2 projekte në vlerë 170,000.00€, Objekte publike, 5 projekte në vlerë 1,130,000.00€, Kanalizime, 2 projekte në vlerë prej 28,897.00€, Ujesjellës, 2 projekte në vlerë prej 152,000.00€, të tjera 2 projekte në vlerë prej 97,945.00€.

**Grafikoni 1:** Përqindja e pjesëmarrjes së investimeve sipas sektorëve.

Ndërsa, nga Programi për Zhvillim Rajonal nga fondi i MAPL-së janë financuar gjithsej 11 projekte, ku përfitues janë 11 komuna lidere dhe 17 komuna partnere në fushat si: Bujqësi, 8 projekte në vlerë 415,000.00 €, Turizëm, 2 projekte në vlerë 140,000.00€, infrastrukturë, 1 projekt në vlerë 15,000.00 €.

Gjatë vitit 2013 investime kapitale në infrastrukturë dhe zhvillim rajonal janë bërë



gjithsejtë 44 projekte në vlerë prej 3,368,257.70 €. Nga Programi i infrastrukturës Ekonomike dhe Sociale të komunave MUNIINFRA - faza VII dhe projekti masat e eficiencës së energjisë në objektet publike shkollore dhe shëndetësore. Nga ky program janë financuar 82 projekte në vlerë prej 30.3 milion, ku përfitues janë 17 komuna.

**Grafikoni 2:** Numri i projekteve sipas sektorëve në 17 komuna.

Përveç rëndësisë së zhvillimit ekonomik lokal, MAPL i ka kushtuar rëndësi edhe bashkëpunimit ndërkomunal, ku vlen të theksohet se gjatë kësaj periudhe është hartuar

raporti vjetor lidhur me aktivitetet e komunave nga fusha e bashkëpunimit ndërkomunal për vitin 2013. Gjithashtu, është përgatitur koncepti dokumenti për bashkëpunimin ndërkomunal dhe binjakëzim, është bërë azhurnimi i të dhënave për bashkëpunim ndërkomunal. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe është bërë identifikimi i 5 komunave në Kosovë për binjakëzim me komunat e vendeve të ndryshme, ku janë identifikuar 7 komuna prej të cilave 5 do të propozohen për binjakëzim. Në këtë drejtim, është mbajtur takimi me qëllim të informimit lidhur me çështjet e Bashkëpunimit ndërkomunal, çështjen e binjakëzimit të komunave dhe ligjin për Bashkëpunim ndërkomunal, ku kanë marrë pjesë 15 komuna.

## **5. integrimet Evropiane dhe Promovimi i Bashkëpunimit Ndërkufitar**

MAPL, gjatë kësaj periudhe ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm edhe sa i përket përmbushjes së detyrimeve nga komunat në procesin e integrimi evropiane. Gjatë periudhës janar-qershor, 2014 është bërë hartimi i raportit vjetor të komunave për zbatimin e PVMSA janar - dhjetor 2013, është bërë hartimi i raportit të komunave për zbatimin e PVMSA janar - mars 2014, është hartuar pyetësori për vlerësimin e kapaciteteve të ZKIE-ve, hartimi i analizës për cilësinë e raportimit të komunave 2014, si dhe është hartuar Analiza e realizimit të detyrave të komunave nga PVMSA komunale për periudhën janar-dhjetor 2013.

Po ashtu, MAPL ka përgatitur Analizën për Organizimin dhe Funkcionimin e strukturave lokale përgjegjëse për integrimi Evropiane, ndërsa obligimet e MAPL-së së bashku me indikatorët PVMSA 2014 dhe Obligimet e komunave nga Plani i Veprimit për Negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit 2014 janë adresuar tek departamentet përkatëse të ministrisë si dhe tek të gjitha Komunitetet.

Gjithashtu, është kompletuar baza e të dhënave për "Raportimin për inputin e Raportit të Progresit 2014 (për periudhën 1 shtator 2013 - 30 prill 2014)", është bërë harmonizimi i të dhënave të raportit të plotësuar në sistem/ dërgimi në adresë të MIE-së "Kontributi i MAPL-së për Raportin e Progresit 2014 të Komisionit Evropian për Kosovën", përgatitja e dokumentit "Raportim në fushën e mbrojtjes dhe respektit të komuniteteve jo shumicë/ Dialogu i Procesit të Stabilizim Asociimit për Sundim të Ligjit" (Alokimi i tokave për personat e kthyer për komunitetin RAE dhe Financimi për gjashtë (6) Qendrat e mësimin në komuna për komunitetin RAE), Finalizimi i të dhënave lidhur me "Raportimin në fushën e mbrojtjes dhe respektit të komuniteteve jo shumicë/Dialogu i Procesit të Stabilizim Asociimit për Sundim të Ligjit", si dhe përgatitja e dokumenteve të nevojshme lidhur me "Takimin parapërgatitor për misionin vlerësues për Liberalizimin e Vizave Blloku i V",

Me qëllim të punës dhe bashkëpunimit dhe avancimit të komunikimit me Komunitet, MAPL ka mbajtur takimet e rregullta me zyrtarët komunal për integritet Evropian, MIE dhe AKK. Në kuadër të detyrave tjera është bërë koordinimi i asistencës së IPA-s dhe asistencës së jashtme bilaterale dhe multilaterale duke marrë pjesë në procesin e programimit dhe aktivitetet dhe punën e strukturave operative të Programeve për Bashkëpunim Ndërkufitar (BNK-së).

Në vazhdimësi, janë dërguar shkresa në adresë të Komunave, me qëllim të përmbushjes së detyrimeve të tyre në procesin e integritet evropian. Ndërsa, me qëllim të avancimit të komunikimit me shoqërinë civile, si një komponentë e rëndësishme e obligimeve nga agjenda Evropiane, në muajin prill të vitit 2014 është themeluar Rrjeti Komunal i Shoqërisë Civile. Me qëllim të qasjes më të lehtë të komunave dhe zyrtarëve të MAPL-së, është krijuar dhe funksionalizuar linku *"INTEGRIMET EVROPIANE"* në kuadër të ueb faqes zyrtare të MAPL-së, ku ky link është plotësuar me nënlinqe dhe dokumente të nevojshme dhe jep informacionin e mjaftueshëm lidhur me procesin e gjithëmbarshtëm të integritet evropian të Kosovës.

Ndërsa, sa i përket bashkëpunimit ndërkufitar, MAPL ka vazhduar punën me tre Task Forcat e Përbashkëta për të finalizuar programimin për vitet 2014-2020 në kuadër të IPA il, për të 3 programet e BNK-së Kosovë - Shqipëri, Kosovë - Mali i Zi dhe Kosovë - Maqedoni. Pas pranimit të komenteve nga Komisioni Evropian për draftet e para të të tri programeve me 09 Janar 2014, ndërsa me datën 7 Shkurt 2014, janë dorëzuar draftet e dyta me ndryshimet e inkorporuar bazuar në komentet e Komisionit Evropian për të tri Programet. Janë organizuar 4 takime të vlerësuesve për *"Vlerësimin e projekt propozimeve të thirrjes së parë për propozime Kosovë-Maqedoni"*, nga muaji mars deri në muajin maj të vitit 2014, Kumanovë-Shkup.

Po ashtu, gjatë kësaj periudhe janë mbajtur edhe takimet e 3-ta të Task forcave për secilin program, ku pritet finalizimi i drafteve të Programeve në kuadër të IPA il 2014-2020. Në kuadër të planit të punës për këtë periudhë është planifikuar që të realizohen edhe takimet konsultative për secilin program dhe të dërgohen 3 programet finale për aprovim në Komisionin Evropian të cilat janë mbajtur në pjesën e dytë të këtij viti (2014) konkretisht më datë 12 Maj është mbajtur takimi konsultativë në Prizren për Programin Shqipëri-Kosovë, me datën 13 Maj në Pejë, është mbajtur takimi konsultativë për Programin Mali i Zi-Kosovë, ndërsa me datë 16 Maj në Gjilan është mbajtur takimi konsultativë për Programin Kosovë-Maqedoni, ndërsa në fundin e muajit Maj janë dërguar në KE për aprovim draftet finale për të 3 programet. Në këtë drejtim, është bërë punë e vazhdueshme dhe koordinim i punëve për plotësimin e Action Document IPA il.

Në kuadër të Programit Shqipëri – Kosovë, sidomos pas përfundimit të TA Grantit për implementimin e programit për BNK KS-AL, janë përgatitur raportet narrative dhe financiare dhe janë dorëzuar në zyrat e BE-së, po ashtu me datë 24 Shkurt 2014, është nënshkruar TA Granti i ri për periudhën 2014-2016, për këtë program. Gjatë kësaj periudhe po ashtu janë përgatitur plotësim - ndryshimet në projekt fishen për aprovimin e Projektit strategjik për ndërtimin e rrugës Krushevë-Shishtavec nga alokimet financiare 2012-2013, janë dërguar plotësimet dhe komentet finale për përmbylljen e ThpP. Ndërsa, më 11 Prill 2014 është aprovuar nga Delegacionet e BE-së në Kosovë dhe Shqipëri raporti i thirrjes së parë për propozime ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë si dhe janë njoftuar aplikantët përfitues të cilët janë përzgjedhur. Me datën 10 Qershor 2014, në Shkodër është mbajtur takimi i Komitetit të Përbashkët Monitorues. Në programin tjetër Maqedoni – Kosovë gjatë kësaj periudhe është mbyllur thirrja e parë për projekt propozime për programin e BNK-së Maqedoni-Kosovë, njëherit ka filluar punën Komiteti i Përbashkët Drejtues për vlerësimin e projekt-propozimeve, e cila punë është duke vazhduar. Sa i përket projektit strategjik për ndërtimin e pikës së përbashkët kufitare Stançiq-Bellanovcë gjatë kësaj periudhe ka vazhduar punën Komisioni i përzier i Eksperteve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë.

Ndërsa, në kuadër të programit Kosovë – Mali i Zi është funksionalizuar zyra e Sekretariatit të Përbashkët Teknik (SPT) në Pejë për programin Kosovë – Mali i Zi, po ashtu është rekrutuar stafi për funksionalizimin e zyrës së SPT-së, njëri ndër aktivitetet kryesore gjatë kësaj periudhe pas lansimit të ThpP me 16 Dhjetor 2013, ka qenë pjesëmarrja dhe organizimi i sesioneve informuese ku përpos mbajtjes së dy sesioneve informuese në vitin 2013, në vitin 2014 janë mbajtur edhe 5 sesione informuese dhe forume për kërkim të partnerëve për këtë program Me datën 24 Mars 2014 është mbyllur afati për aplikim në kuadër të ThpP dhe është filluar me themelimin e Komitetit të Përbashkët Drejtues. Me datën 10 Prill 2014 është mbajtur takimi i Komitetit të përbashkët Monitorues në Podgoricë, Mali i Zi, ku janë aprovuar Plani i punës dhe Plani i komunikimit për Sekretariatit të Përbashkët Teknik.

## **6. Transparenca e punës së MAPL-së**

MAPL gjatë kësaj periudhe (janar –qershor, 2014) rëndësi i ka kushtuar edhe transparencës në komuna, ku vlen të theksohet se gjatë kësaj periudhe janë siguruar kontaktet për zyrtarët komunal që janë përgjegjës për qasjen në dokumente publike. Është bërë vazhdimisht monitorimi i ueb faqeve zyrtare të këtyre komunave të Republikës së Kosovës. Në këtë drejtim, janë zhvilluar edhe një seri e takimeve me organizata jo-qeveritare vendore dhe ndërkombëtare si: INPO, DILENS , OSBE-n, LOGOS dhe me UNDP-n.

Gjithashtu, janë zhvilluar 5 punëtori regjionale, ku kanë marrë pjesë 120 përfaqësues nga komunat, shoqëria civile dhe mediat lokale. Punëtoritë kanë trajtuar temën e klasifikimit të dokumenteve publike dhe mbrojtjen e të dhënave personale, ndërsa janë organizuar në kuadër të projektit për forcimin e transparencës në komuna dhe respektimit të ligjit për Qasje në Dokumente Publike. Ndërsa, në bashkëpunim me institutin e Kosovës është organizuar trajnimi me zyrtarët për komunikim, ku qëllimi i trajnimit ka qenë avancimi i transparencës në komuna (Ligji për qasje në dokumentet publike, takimet e hapura me qytetarë) dhe rolin e zyrtarëve për komunikim në këtë proces, me ç'rast kanë marrë pjesë 24 zyrtarë nga komunat Kosovës. Sa i përket fushatës informuese për transparencën në komuna, duhet cekur se me qëllim të informimit të qytetarëve për të drejtën në informacion, në muajin shkurt ka nisur projekti për fushatën informuese të MAPL-së për transmetimin on-line të mbledhjeve të asamblesë komunale që do të pasohet me organizmin e një tryeze më grupe të interesit (*media, shoqëri civile*) dhe transmetimin e spotit televiziv që ju bën thirrje qytetarëve për t'i përcjellë on-line mbledhjet e asamblesë komunale. Kurse, nga data 20 mars deri më 15 qershor është transmetuar spotit televiziv në Radio Televizionin e Kosovës lidhur me të drejtën e qytetarit për qasje në informata në komuna dhe obligimin e institucioneve për ta zbatuar Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.

Gjatë periudhës janar-qershor 2014, MAPL ka pasur bashkëpunim edhe më shoqërinë civile dhe mediat, ku ka pranuar dhe proceduar 05 kërkesa (02 media, 03 shoqëria civile) për qasje në dokumente publike dhe informatat për palët janë ofruar brenda afateve kohore të përcaktuara me ligj. Më tej, MAPL-së, përmes zyrës së informimit gjatë kësaj periudhe iu janë drejtuar 42 kërkesa të gazetarëve lidhur me interesime për proceset e Ministrisë veçanërisht pyetje lidhur me konstituimin e komunave të reja, të cilat janë shqyrtuar me kohë dhe kanë marrë përgjigje nga Ministria. Pastaj, janë dërguar në media 17 informata lidhur me aktivitetet publike të MAPL-së dhe dy sqarime (gazeta JUNK, Rrjeti për Gazetari Hulumtuese dhe Gazeta Koha ditore) për përmbajtjen e informatave jo të sakta, janë organizuar 23 intervista të Sekretarit të Përgjithshëm në televizionet e Kosovës që kanë transmetuar informata lidhur me konstituimin e organeve të reja lokale në Veri të Kosovës, si dhe në periodike janë përgatitur raportet e monitorimit të medieve lidhur me procesin e bisedimeve në Bruksel me rastin e konstituimit të organeve të reja lokale.

Në kuadër të aktiviteteve të saj, MAPL gjatë kësaj periudhe (janar - qershor, 2014) ka publikuar gjithsej 296 informata që përfshijnë raporte të monitorimit për komunat, shkresa ligjore për komunat, raportet periodike të MAPL-së, ende të lira pune, thirrje për propozime, informata nga prokurimi publik dhe aktivitete ditore të MAPL-së si dhe është publikuar edhe linku lidhur me informata për procesin e integritimeve evropiane.



Vlen të cekët se gjatë kësaj periudhe Rrjeti Kosovar për Gazetari Hulumtuese BIRN, në mesin e të gjitha institucioneve ekzekutive ka vlerësuar MAPL-në si institucionin me transparent në ofrimin e informatave për publikun ashtu siç parashihet me ligj. Ky vlerësim është bërë prezantimin e raportit lidhur me matjet e transparencës së institucioneve në fushën e Zbatimit të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike dhe komunikimit me media.

## 7. Zhvillimi i Kapaciteteve dhe Performanca Komunale

Në gjashtëmuorin e parë të vitit 2014 MAPL ka realizuar raportimin e të dhënave për shërbimet komunale në Sistemin e Menaxhimit të Performancës së Shërbimeve Komunale për pesëmbëdhjetë shërbimet publike komunale të cilat janë në kompetencë të komunave, pastaj është bërë korrigjimi dhe përpunimi i të dhënave të cilat janë dërguar nga të gjitha komunat e Kosovës, është përgatitur Raporti i Performancës së Shërbimeve Komunale për vitin 2013, si dhe është bërë publikimi i Raportit vjetor të Performancës së Shërbimeve Komunale për vitin 2013.

Në vazhden e aktiviteteve të saj MAPL ka vazhduar bashkëpunimin me nivelin lokal, sidomos ka vazhduar komunikimi me komunat, me koordinatorët komunal për performancë në lidhje me saktësinë e të dhënave për performancën komunale të cilat janë raportuar nga ana e tyre në Sistemin e Menaxhimit të Performancës së Shërbimeve Komunale. Më tej, është hartuar raporti analitik për Performancën e Komunave për vitet 2013/2012 (analiza dhe krahasimi i të dhënave komunale për dy vitet e kaluara). Po ashtu, janë zhvilluar takime të ndryshme ndër - institucionale me qëllim Përparimit të Zhvillimit të Qëndrueshëm në Kosovë”, nga orientimet strategjike drejtë operacionalizimit, ku përveç MAPL-së kanë marrë pjesë edhe MMPH, MPB, MPMS, MKK, MIE, AAK dhe UN Habitat, pastaj janë mbajtur dy punëtori me qëllim të shtimit të fushave të reja në Sistemin e Menaxhimit të Performancës së Shërbimeve Komunale. Këto punëtori janë mbajtur të ndara me temat: *“Promovimi dhe Mbrojtja e të Drejtave të Njeriut”* dhe *“Mbrojtja e Mjedisit Lokal”*, ku në të gjitha këto takime prezantuar Sistemi i Menaxhimit të Performancës së Shërbimeve Komunale

Sa i përket ngritjes së kapaciteteve në komuna, MAPL konform objektivave të saj, ka hartuar modulet e trajnimeve në komuna, si dhe modulet për zyrat e integriteteve evropiane në komuna, pastaj në bashkëpunim me partnerët vendor dhe ndërkombëtar është hartuar Plani Kalendarik i Trajnimeve të Nëpunësve Civilë në Komuna, ku janë mbajtur këto trajnime: MAPL-UNDP - Stabilizim Asociimi dhe Zhvillim Lokal, pjesëmarrja 36 zyrtar; MAPL-IKAP- Zbatimi i ligjit për qasje në dokumente publike, pjesëmarrja 29 zyrtar; MAPL - IKAP- Negociatat me BE- për nënshkrimin e MSA, pjesëmarrja 26 zyrtar; MAPL-IKAP - Ngritja e efikasitetit në Administratën Lokale, 27 pjesëmarrës; MAPL-IKAP - Menaxhimi pronës Komunale, pjesëmarrja 33 zyrtar; MAPL

-IKAP- Barazia gjinore në të drejtën e pronës, pjesëmarrja 11 zyrtar; MAPL -OSBE - Klasifikimi dhe mbrojtja e të dhënave personale, Gjakovë, Pejë, Istog, Klinë, Deçan dhe Junik, pjesëmarrja 23 zyrtar; MAPL- OSBE- Klasifikimi dhe mbrojtja e të dhënave personale, Suharekë, Malishevë dhe Prizren, pjesëmarrja 21 zyrtar.

Gjithashtu, është hartuar dhe implementuar pjesa e trajnimeve të gjashtëmujorit të parë të Planit të Trajnimeve për Zyrtarët e Komunave Leposaviq, Zubin-Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut, ku aktualisht janë duke u mbajtur trajnimet me zyrtarët e këtyre komunave. Gjatë kësaj periudhe ka vazhduar bashkëpunimi me partnerët: iKAP, UNDP, OSBE dhe me Ambasadën e Kosovës në Slloveni për çështjen e bashkëpunimit në fushën e trajnimeve të zyrtarëve të komunave të Republikës së Kosovës, si dhe janë bërë propozimet e temave për trajnime në Slloveni në vitin 2015. Po ashtu, janë përgatitur thirrjet publike për projekt-propozimet për grante nga MAPL-ja, shpallja e parë e thirrjes është bërë me 10 mars, ku më pas nga komisioni vlerësues janë përzgjedhur 15 projekt propozime nga OJQ-të, ku vlera financiare e ndarë për OJQ-të, fituese është 106, 005.00 euro. Po ashtu është shpallur edhe faza e II e thirrjes publike për projekt-propozimet nga OJQ-të, me 21 maj e cila është tani në proces të vlerësimit të projekt propozimeve. Është hartuar Pyetëtori për Vlerësimin e Kapaciteteve Profesionale në Komuna. Me vendim të qeverisë MAPL në bashkëpunim me Agjencinë Kadastrale të Kosovës dhe me kryetarët e komunave të Kosovës është mbajtur takimi për procesin e emërimit të rrugëve. Është hartuar raporti për Bruksel për çështjen e ngritjes së kapaciteteve në komuna, si dhe janë hartuar dhe dërguar pyetëtorët për plotësimin e të dhënave për profilet e komunave të reja: Rogovë, Komoran, Kijevë, Rugovë, Zhegër etj.

## **8. Promovimi i të drejtave të njeriut në Komuna**


Në kuadër të promovimit dhe respektimit të drejtave të njeriut në komuna, MAPL gjatë kësaj periudhe ka realizuar një sërë aktivitetesh në fushën e të drejtave të njeriut. Janë hartuar raportet vjetore të respektimit të drejtave të njeriut në komuna, si dhe janë hartuar dokumente tjerë analitike me qëllim të promovimit të drejtave të njeriut. MAPL në këtë periudhë po ashtu ka hartuar raportin për zbatimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 2011/04 për krijimin e njërive për të drejtat e njeriut në komuna dhe ka përgatitur bazën e të dhënave për komunitetin RAE, pastaj raportin tabelor për përfaqësimin minoritar, për femrat në pozita vendimmarrëse dhe raportin për përdorim e gjuhëve zyrtare dhe gjuhëve në përdorim zyrtarë. Më tej është hartuar raporti për komunat që zbatojnë rregulloret e nxjerra për përdorimin e gjuhëve, hartimi i raportit për të drejtat e fëmijëve, dhunës në familje dhe barazisë gjinore, raportin kundër trafikimit me njerëz, informatat për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, pastaj hartimi i letrave për kryetarët e komunave për përdorimin e gjuhëve, për emërimin e zyrtarëve për personat

e zhdukur, rekomandimet për themelimin e komitetit konsultativ për personat me aftësi të kufizuara, letrës për zbatimin e ligjit për të verbrit.

MAPL ka vazhduar me fushatën senzibilizuese për regjistrimin *FALAS* të komunitetit RAE në komuna, ku është monitoruar ecuria e fushatës për procesin e regjistrimit falas, si dhe është hartuar raporti se cilat komuna kanë bërë fushatë për regjistrimin falas dhe sa persona janë regjistruar gjatë fushatës. Në 17 komuna janë regjistruar 228 persona, 39 familje, 37 rom, 21 ashkali si dhe 8 egjiptian. MAPL ka realizuar vizita monitoruese/këshilluese në 13 komuna të Republikës së Kosovës, gjatë këtyre takimeve, zyrtarët komunal janë këshilluar për formimin e KKK për PAK dhe hartimin e udhëzuesit për shërbimet komunale për PAK. Gjatë kësaj periudhe (janar – qershor, 2014) MAPL ka zhvilluar takimet e rregullta me shoqatën e të verbërve për realizimin e projekteve në komuna dhe rekomandimin për themelimin e komitetit konsultativ për personat me aftësi të kufizuara si dhe lidhur me zbatimin e ligjit për personat të verbër dhe me të pamë të dobësuar. Është shpërndarë letër për Kryetarët e komunave për përdorimin e gjuhëve, për emërimin e zyrtarëve për personat e zhdukur, si dhe shkresën rekomanduese për themelimin e komitetit konsultativ për personat me aftësi të kufizuara.

MAPL në bashkëpunim me OSBE-në, ka mbajtur punëtori një ditore në tri regjione të Republikës së Kosovës (Prishtinë, Prizren dhe Gjilan). Temat e trajnimit kanë qenë : “Fuqizimi i grave dhe vajzave për pjesëmarrje në proceset vendim-marrëse me fokus”; “Të Drejtat e Grave me Aftësi të Kufizuara dhe Grave nga zonat rurale” si dhe “Promovimi dhe mbrojtja e të Drejtave të Njeriut”. MAPL ka mbajtur takimi me kryeshefen e ABGJ-së e cila ka kërkuar nga MAPL që të gjitha Njësit për të Drejtat e Njeriut të bëhen zyre, ndërsa MAPL-ja ka kundërshtuar një vendim të tillë gjë që njësit do të vazhdojnë të funksionojnë ashtu siç janë konform UA. 2011/4. Është mbajtur takimi me komisionarët për gjuhë me ç’rast është publikuar udhëzuesi për zbatimin e ligjit për përdorimin e gjuhëve, si dhe takimi me operatorin ekonomik LET ish ePayTech lidhur me zbatimin e projektit INVOLV ku janë dorëzuar certifikatat për kandidatët të trajnuar për trajner, nga komuniteti i personave me aftësi të kufizuara, nga 12 kandidatët 8 janë certifikuar me ECDL Start, Syllabus Version 4.0 dhe 4 kandidat janë certifikuar me licencë Syllabus Version 5.0.

## 9. Administrata dhe Financat



Me qëllim të plotësimit të obligimeve ligjore si dhe realizimin e punëve, aktualisht në MAPL janë të punësuar gjithsejtë 120 shërbyes civil, prej tyre: 65 meshkuj dhe 55 femra, me këtë përbërje etnike: 10 serb, 1 boshnjak dhe 3 turq dhe tjerët shqiptar, duke respektuar kështu të drejtat e veçanta të komuniteteve për përfaqësim në administratë publike.

**Diagrami 2:** Pasqyrimi i të punësuarve (shërbyesve civil në MAPL, periudha janar – qershor, 2014.

Ndërsa, për zhvillimin e punës së saj dhe arritjes së qëllimeve të paracaktuara, për këtë vit MAPL-ja ka në dispozicion një shumë prej 5,065,000.00 € të ndara nga buxheti shtetit, ndërsa gjatë gjashtëmujorit të parë janar – qershor të këtij viti buxheti është shpenzuar në shumën prej 741,662.87 €, ose shprehur në përqindje 14.64 %.